

# Më të mbrojtur me vaksinën HPV

FUSHATA E VAKSINIMIT  
KUNDËR PAPILOMA VIRUS

PARANDALIMI I INFEKSIONEVE  
DHE I TUMOREVE  
**PËR DJEM E VAJZA**





## ÇFARË ËSHTË PAPILOMA VIRUS (HPV)?

Bëhet fjalë për një grup virusesh shumë të përhapur. Ekzistojnë mbi 100 sierotipa, nga të cilat më shumë se 40 mund të shkaktojnë infeksione të aparatit gjenital femëror dhe mashkullor.

Në përgjithësi infeksionet nga HPV janë kalimtare, asimptomatike (d.m.th. personi nuk vëren asgjë) dhe në shumicën e rasteve shërohen spontanisht. Disa sierotipa HPV mund të shkaktojnë alterime qelizore në mukozën e organeve gjenitale (qafën e mitrës, vulvën, vagjinën, anusin, penisin dhe orofaringun) të cilat, nëse janë të vazhdueshme dhe nëse nuk kurohen, mund të arrijnë të shndërrohen në tumore, madje edhe pas shumë viteve.

---

## SI TRANSMETOHET PAPILOMA VIRUS?

**Transmetohet nëpërmjet marrëdhënieve seksuale, edhe nëse nuk janë të plota.**


Është infeksioni më i zakonshëm që transmetohet me rrugë seksuale. **Përdorimi i prezervativit zvogëlon, por nuk e parandalon, transmetimin e virusit** pasi ky mund të jetë i pranishëm edhe në pjesët e lëkurës që nuk mbrohen nga prezervativi.

---

## SI KUROHET INFEKSIONI NGA PAPILOMA VIRUS?

**Nuk ekziston një kurë specifike.**

Për të diagnostikuar në kohën e duhur alterimet në qelizat e qafës së mitrës të shkaktuara nga virusi HPV, **është e nevojshme që t'i përmbahemi rregullisht ftesës për të kryer testin HPV ose Pap-testin për screening.** Për vendet e tjera (vulvë, vagjinë, anus, penis dhe orofaring) aktualisht nuk ka programe për screening.



## A ËSHTË E SIGURT VAKSINA? SI ËSHTË E BËRË?

**Vaksina është e sigurt.** Përbërja e saj garanton se nuk mund të shkaktojë infeksion, por është në gjendje të induktojë një përgjigje imuniteti kundër virusit. Studimet e shumta të bëra deri më sot, si dhe sistemet eurvejimit post marketing të të gjitha vendeve evropiane dhe jo-evropiane, kanë demonstruar se vaksina tolerohet mirë. Miliona njerëz janë vaksinuar kundër HPV dhe nuk janë raportuar reagime të rënda. Mund të vërehen dhimbje dhe skuqje në zonën e injektimit, ethe, neveri, marramendje, dhimbje koke dhe dhimbje të kyçeve. Në përgjithësi janë simptoma të lehta dhe me kohëzgjatje të shkurtër.

---

## A E PARANDALON INFEKSIONIN VAKSINIMI KUNDËR HPV?

**Vaksina parandalon infeksionin nga sierotipat që përmbahen në vetë vaksinën dhe për këtë arsye ndalon edhe formimin e atyre alterimeve qelizore që mund të çojnë në tumor.**

---

## A ËSHTË EFIKASE VAKSINA?

**Po.** Nga studimet e shumta klinike që janë bërë është demonstruar se vaksina, nëse soministrohet kur personi nuk ka pasur akoma kontakt me virusin, përpara fillimit të aktivitetit seksual, siguron një mbrojtje shumë të lartë ndaj dëmtimeve parakanceroze dhe kanceroze dhe ndaj kondilomave (lythat gjenital). Vaksina që përdoret aktualisht në Emilia-Romagna është efiikase kundër 9 tipave të papiloma virusit human dhe mbron nga pothuajse 90% e tumoreve të qafës së mitrës, rreth 80% ndaj tipave të tjerë të tumoreve që kanë lidhje me HPV dhe pothuajse 100% të kondilomave.

## PËR SA KOHË ZGJAT EFIKASITETI I VAKSINËS?

Studimet dëshmojnë qëndresën e antitropave për shumë vite, ndoshta gjatë gjithë jetës. Deri më sot, në fakt, nuk parashikohet asnjë përsëritje vaksinimi pas ciklit bazë.

## PËR KË REKOMANDOHET VAKSINIMI?

**Vaksina ka si qëllim parandalimin e infeksionit, jo atë të shërimit:** pra duhet të soministrohet përpara kontaktit të mundshëm me virusin, domethënë përpara fillimit të marrëdhënieve seksuale. Në qoftë se vajza ose djali tashmë kanë hyrë në kontakt me sierotipat e virusit që gjendet në vaksinë, efikasiteti zvogëlohet.

## KUJT I DREJTOHET VAKSINIMI FALAS?

Shërbimi shëndetësor rajonal garanton vaksinimin falas për të gjitha vajzat dhe djemtë në vitin e dymbëdhjetë të jetës së tyre. Njësia sanitare lokale (USL) e rezidencës fton, vajzat dhe djemtë e interesuar që të bëjnë vaksinimin, me anën e një letre që ua dërgon në shtëpinë e tyre. Vajzat të cilave u është ofruar vaksinimi falas, duke filluar nga ato që kanë lindur në vitin 1996, kanë të drejtë që ta bëjnë falas vaksinimin derisa të mbushin moshën 26 vjeç. Fëmijët e mbajnë të drejtën e vaksinimit falas deri në moshën 18 vjeç, duke filluar nga ata që kanë lindur në vitin 2006.

# Më të mbrojtur me vaksinën HPV

FUSHATA E VAKSINIMIT  
KUNDËR PAPILOMA VIRUS

## **KU DHE SI KRYHET VAKSINIMI FALAS?**

Vaksinimi kryhet nga operatorët sanitarë të ambulatorëve të vaksinimit të Ndërmarrjeve USL. Në varësi të moshës, parashikohen dy ose tre injeksione intramuskulore në deltoid (pjesa lart e krahut).

## **A KËSHILLOHET VAKSINIMI EDHE PËR TË RRRITURIT?**

**Studimet klinike kanë demonstruar se vaksina ruan një efikasitet të mirë edhe tek personat e rritur, megjithëse më të ulët se në adoleshencë, duke pasur parasysh probabilitetin e lartë se kanë pasur kontakte me virusin HPV për sa i përket aktivitetit seksual.**

**Për këtë arsye, Shërbimi sanitar rajonal gjithashtu ofron vaksinim edhe për personat e rritur dhe fëmijët që kanë lindur përpara vitit 2006, në ambulatorët e vaksinimit të Ndërmarrjeve USL, me një çmim të zbritur.** Kostoja në ngarkim të pacientëve është dukshëm më e ulët se ajo që praktikohet privatisht dhe korrespondon vetëm me koston e vaksinës për Ndërmarrjen USL, plus koston e vaksinimit sipas tarifës rajonale.

## **A KA MUNDËSI QË VAKSINA T'U SOMINISTROHET GRAVE SHTATZËNA?**

Jo, në qoftë se një vajzë zbulon se është shtatzënë, pas fillimit të ciklit të vaksinimit, ajo duhet të presë fundin e shtatzënisë para se ta përfundojë ciklin e vaksinimit.

## **EDHE NË QOFTË SE JENI E VAKSINUAR, A DUHET TË BËNI NJË SCREENING PËR TUMORIN E QAFËS SË MITRËS?**

Po. Screening gjithashtu lejon që të dalin në pah alterimet qelizore të shkaktuara nga sierotipat e tjerë të HPV që nuk përmbahen në vaksinë.

